

UDHËZIM
Nr. 11, datë 30.6.2016

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 52, DATË 3.12.2015, “PËR
PËRCAKTIMIN E NIVELEVE TË GJUHËVE TË HUAJA DHE TË TESTEVE
NDËRKOMBËTARE, PËR PRANIMET NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT
TË DYTË DHE TË TRETË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 4, të nenit 76 dhe të pikës 3, të nenit 78, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë,

UDHËZOJ:

1. Pas pikës 9 të udhëzimit nr. 52, datë 3.12.2015, shtohet pika 9/1 me këtë përmbajtje:

“9/1 Certifikata, diploma apo dëshmia e lëshuar nga subjektet që gëzojnë të drejtën e pronësisë intelektuale për ofrimin e testeve ndërkombëtare jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, njihen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, pas konfirmimit të secilit dokument nga subjektet që ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që kanë nënshkruar marrëveshje me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për testin përkatës, sipas tabelës 1 bashkëngjitur këtij udhëzimi.”.

2. Pika 10 e udhëzimit nr. 52, datë 3.12.2015, shfuqizohet.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Drejtoria e Shërbi-meve Juridike në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, si dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla